Përndryshe, sipas vëzhgimeve tona, membrana e buzëve hollohet me kalimin e moshës. Marrëdhëniet midis këtij karakteri dhe karakteristikave të ndryshme dentare, siç është okluzioni, do të diskutohen në kapitullin e ardhshëm. Për momentin, mjafton të thuhet se pjesërisht pamja e buzëve të Malësorëve të Gegnisë, që është e ngjashme me atë të George Washington-it, shfaqet për shkak të moshës. Lobi i veshit gjithashtu rritet në mënyrë të qëndrueshme, ngadalë deri në fillim të të 50 - ave, dhe pastaj rritet më shpejt. Flegrat e hundës ndryshojnë pak. Maja, megjithatë, trashet gradualisht deri në fund të të 40 - ave dhe pastaj hollohet dalëngadalë.

Këto ndryshime janë shumë të vogla dhe të rëndësishme vetëm për qëndrueshmërinë e tyre. Pozicioni i majës së hundës, megjithatë, ndryshon në mënyrë të qëndrueshme dhe të rëndësishme me moshën. Frekuenca e lartë e majave të përkulura në serinë tonë është pjesërisht një reflektim i këtij fenomeni. Përveç formës së pjesës së pasme të kokës, elementi më dallues i Dinarikëve është profili i hundës. Malësorët tanë Gegë me frekuencën e lartë të hundëve si të shkabës janë krejtësisht e veçantë.

Në përqindjen e serisë tonë, një frekuencë prej 50 për qind ose më shumë për profilet konvekse arrihet vetëm nga fundi i të 20 - ave. Kështu që ajo mbetet thuajse e njejtë deri në fund të të 50 - ave dhe pastaj rritet dukshëm, ndoshta pasi pjesët e buta të hundës hollohen dhe vetë maja e saj zgjatet nga poshtë. Dallimet mesatare të moshës midis atyre me profile konkave dhe konvekse, si dhe

midis profileve të drejta dhe konvekse, janë të rëndësishme. Po ashtu, dallimet në përqindje midis grupit të moshës 20 - 24 vjeç dhe tre kategorive më të moshuara janë gjithashtu të rëndësishme. Nëse dikush do të maste një seri Malësorësh Gegë 20 - vjeçarë, ndoshta do të gjente hundë të drejta me shumicë, me forma konkave që shfaqen ndoshta po aq shpesh sa edhe format konvekse. Hunda konvekse, aq dalluese për dinarikët, është pjesërisht një veçori e moshës. Po ashtu është edhe fytyra e gjatë, ashtu siç janë edhe buzët e holla. Burri Dinarik 'tipik' duket kur e ka kaluar moshën mesatare.

MOSHA DHE FLOKËT

Tabela 14 dhe figura 5 tregojnë ndryshimet në pilozitet[7] që ndodhin në grupin tonë me kalimin e moshës. Rreth 13 për qind të individëve që ne kemi matur i kanë humbur flokët në një masë të caktuar. Siç tregon Tabela 14, kjo përqindje rritet në mënyrë të vazhdueshme me rritjen e moshës. Asnjë nga grupi më i ri i moshës nuk kishte rënie flokësh, ndërsa 22 për qind e individëve më të moshuar kishin humbje të flokëve. Trashësia e flokëve në kokë, në rastet kur kishte mbetur ende ndonjë fije, zvogëlohet gradualisht duke filluar nga mosha 30 vjeç e tutje, megjithatë ky ndryshim nuk shfaqet dhe aq i madh.

TABLE 14: AGE AND HAIR QUANTITY.
Means of Criteria*

AGE	No.	BALDNESS	HEAD	No.	MUSTACHE	CHEEKS	JAW	ARMS & LEGS	CHEST
18–20.....	12	0	54.17	12	41.67	18.75	22.50	27.50	8.33
21–24.....	99	1.77	50.51	99	39.90	28.66	30.93	34.47	17.05
25–29.....	153	3.03	49.68	155	42.55	37.66	40.41	40.73	27.10
30–34.....	162	4.27	50.62	166	48.27	45.63	47.97	44.58	34.86
35–39.....	159	5.82	48.59	162	56.32	50.39	53.24	47.53	36.65
40–44.....	129	9.42	48.05	129	57.75	53.49	54.55	49.71	41.96
45–49.....	99	12.55	47.19	103	58.50	52.31	55.34	49.51	43.08
50–54.....	83	13.56	46.48	88	57.95	52.41	56.25	51.99	45.00
55–59.....	51	17.15	41.67	52	58.65	55.39	56.73	48.56	40.62
60–64.....	56	17.62	40.85	56	58.48	55.80	57.14	49.55	48.21
65 + ...	41	18.62	42.07	41	60.06	57.32	58.23	46.34	61.89

7 Pilozitet" i referohet pranisë së qimeve ose mbulesës me qime në trupin e një individi, zakonisht në kontekstin e shkallës së qimeve në lëkurë. Ky term përdoret shpesh në fushat e mjekësisë, biologjisë ose dermatologjisë për të përshkruar tiparet e qimeve të trupit të njerëzve apo kafshëve. (Shënim i përkthyesit)

Age Means

	Abs.		ssm		sm		+		++	
	No.	Mean	No.	Mean	No.	Mean	No.	Mean	No.	Mean
Baldness	803	36.79	22	47.68	128	48.21	71	49.03	19	50.18
Head Hair Quant.....					143	48.70	842	37.88	58	37.43
Mustache ...			16	23.87	81	26.57	727	39.10	239	45.59
Cheek	50	28.10	52	32.38	189	39.12	540	39.95	232	45.71
Jaw	21	24.68	28	27.00	183	32.87	593	40.05	238	45.80
Arms and Legs			16	32.00	280	34.27	636	40.53	131	45.93
Chest	249	32.74	14	41.29	243	38.44	377	41.48	169	46.20

*See footnote to table 13.

(*Note:* Chest +++: 11 49.27)

Tabela 14 dhe figura 5 tregojnë ndryshimet në pilozitet8 që ndodhin në grupin tonë me kalimin e moshës.

Në qimet e fytyrës, mustaqet janë të parat që rriten, gjë që është normale dhe më pas këto pësojnë ndryshime relativisht të vogla. Në këtë rast, mosha nuk është një faktor shumë i rëndësishëm. Qimet në faqe dhe nofull rriten në raportin 3:1 dhe 2:1. Nga qimet e trupit, ato të krahëve dhe këmbëve rriten në të njëjtën mënyrë si qimet e faqeve dhe nofullës deri në moshën 30 vjeç, dhe pastaj mbeten konstante.



Figura 5 jep grafikun e moshës dhe të flokëve të lidhura me mustaqet, duart, këmbët, nofullat, faqet dhe gjoksin.

8 Pilozitet" i referohet pranisë së qimeve ose mbulesës me qime në trupin e një individi, zakonisht në kontekstin e shkallës së qimeve në lëkurë. Ky term përdoret shpesh në fushat e mjekësisë, biologjisë ose dermatologjisë për të përshkruar tiparet e qimeve të trupit të njerëzve apo kafshëve. (Shënim i përkthyesit)

Qimet e gjoksit rriten më shumë se të gjitha llojet e tjera të qimeve të vëzhguara. Me një popullsi të tillë, dhe kjo vlen për shumicën e racave, por ndofta jo për të gjithë popujt "e bardhë", është e kotë të krahasosh 20-vjeçarët, siç regjistrohen zakonisht në statistikat e ushtrisë, me një mostër të pjekur si kjo e jona. Megjithatë kampionet me moshë mesatare midis 35 dhe 60 vjeç do të ishin të krahasueshme. Kjo do të thotë që kampionet tona fisnore, pavarësisht nga ndryshimet e mëdha në moshë, mund të krahasohen normalisht me njëra tjetrën në 7 kriteret e qimeve të përdorura në këtë studim.

MOSHA DHE ZBARDHJA E FLOKËVE

Tabela 15 dhe Figura 6 tregojnë ndryshimet që ndodhin me moshën në rënien e flokëve dhe humbjen e ngjyrës së tyre me kalimin e kohës, proces i cili njihet si thinja e flokëve. Flokët e kokës fillojnë të zbardhen në një moshë më të hershme se ato të mustaqeve, të cilat i tejkalojnë flokët e kokës në zbardhje në fund të të 50-ave. Ndërsa sasia e flokëve arrin fazën e saj të pjekurisë në të 30-at dhe pastaj stabilizohet, procesi i zbardhjes ndjek një trajektore të ndryshme. Nga fillimi i të 30 - ve deri në fund të të 40 - ve, zbardhja përparon me një ritëm që shfaqet si parabolë në një grafik linear dhe si vijë e drejtë në një rrjetë gjysmë-logaritmike. Pas fundit të të 40 - ve, ritmi ndryshon, duke marrë formën e një funksioni të vetëm logaritmik.

TABLE 15: AGE AND GRAYING.

	Degree of Grayness by Age Groups				Per cent Remaining Totally Ungrayed	
	HEAD		MUSTACHE			
AGE	No.	MEAN*	No.	MEAN	HEAD	MUSTACHE
18–20.....	12	0	12	0	100.00	100.00
21–24.....	99	.25	99	0	98.99	100.00
25–29.....	155	3.67	155	.48	89.03	98.71
30–34.....	166	2.95	166	.30	90.36	99.40
35–39.....	161	7.38	161	2.17	75.78	91.93
40–44.....	130	16.44	129	9.50	59.23	72.87
45–49.....	103	29.00	103	22.32	36.89	43.69
50–54.....	88	35.23	88	31.68	25.00	37.50
55–59.....	52	41.82	52	37.02	21.15	28.85
60–64.....	56	55.12	65	57.14	8.93	3.57
65 + ...	41	69.82	41	73.50	2.44	0

Mean Ages of Degrees of Graying	Head		Mustache	
	#	Age	#	Age
Abs	674	33.49	766	33.98
ssm	26	42.67	4	(47.00)
sm	119	44.22	83	46.52
+	140	47.89	127	53.38
++ ..	77	56.02	64	59.30
+++	17	60.82	11	(65.18)
White .	9	63.67	7	(64.86)

	Degree of Grayness All Ages		Mean Ages of Hair Color Groups		
	#	Mean*	#	Mean	Age
Black	420	24.84	420	43.39	.40
Dark brown.....	473	8.53	473	35.45	.29
Reddish-brown ...	16	13.42	16	(40.12)	
Light brown.....	89	4.64	89	35.42	
Blond	24	6.25	24	(37.42)	

*By method explained in footnote to table 13.

TABLE 15: AGE AND GRAYING.

	Degree of Grayness by Age Groups				Per cent Remaining Totally Ungrayed	
	Head		Mustache			
Age	No.	Mean*	No.	Mean	Head	Mustache
18–20.....	12	0	12	0	100.00	100.00
21–24.....	99	.25	99	0	98.99	100.00
25–29.....	155	3.67	155	.48	89.03	98.71
30–34.....	166	2.95	166	.30	90.36	99.40
35–39.....	161	7.38	161	2.17	75.78	91.93
40–44.....	130	16.44	129	9.50	59.23	72.87
45–49.....	103	29.00	103	22.32	36.89	43.69
50–54.....	88	35.23	88	31.68	25.00	37.50
55–59.....	52	41.82	52	37.02	21.15	28.85
60–64.....	56	55.12	65	57.14	8.93	3.57
65 + ...	41	69.82	41	73.50	2.44	0

Tabela 15 na jep një pamje të moshës dhe të zbardhjes së flokëve, si dhe shkallën e shfaqjes së këtij fenomeni tek Gegët e Malësisë shqiptare, sipas grupeve, kokave, mustaqeve dhe ngjyrës së flokëve, të gjitha të studiuara nga Prof. Coon në Malësi e Madhe, Dukagjin, Malësia e Gjakovës, Hasi, Luma, Puka, Mirdita, Zadrima, Mati dhe Dibra.



Figura 6 paraqet zbardhjen e flokëve sipas moshës, shkallën e zbardhjes dhe rënien e flokëve në varësi të moshës, sipas grupeve.

Nga kjo duket se të paktën dy faktorë fiziologjikë janë përgjegjës për këtë fenomen dhe njëri aktivizohet më vonë se tjetri. Kur rënia e flokëve merret nga seksioni i mëparshëm dhe plotësohet në të njëjtin grafik, ajo ndërpritet në të njëjtën moshë si zbardhja në dy pjesët anatomike të studiuara. Kjo është e njëjta pikë në grafikun e moshës ku forca, siç tregohet nga tendosja e dinamometrit, bie ndjeshëm. Pleqëria, tek malësorët e Gegënisë, fillon të shfaqet në mesin e të 40-ave.

MOSHA DHE NDRYSHIMET E NGJYRËS SË FLOKËVE

Në të gjitha rastet, përveç 28 prej tyre (ose 2.6%), ishte e mundur të gjendeshin mjaftueshëm flokë të pigmentuar dhe gri për të vënë re ndryshimin në ngjyrën e tyre. Siç tregon edhe Tabela 15, flokët e zinj ishin më shpesh dhe më shumë të prekur nga zbardhja sesa çdo lloj floku tjetër. Flokët e zinj dhe kafe të kuqërremtë rezultuan me shumë më shumë zbardhje sesa tre kategoritë e tjera të ngjyrave, të gjitha më të çelëta. Këto priren të formojnë një grup. A ndodh kjo sepse burrat me flokë të zinj zbardhen më shpejt sesa burrat me flokë kafe dhe të çelët, apo sepse disave prej tyre iu kthehen flokët në më të errët kur plaken? Neve nuk mund t'i përgjigjemi kurrë kësaj pyetje me siguri të plotë derisa të kemi studiuar ndryshimet kronologjike tek të njëjtët burra. Gjithësesi provat që kemi sot favorizojnë përfundimin e dytë. Burrat me flokë kafe të errët janë mesatarisht 8 vjet më të rinj se burrat me flokë të zinj, në kuptimin që ky dallim arrin deri në mbi 16 herë gabimin e saj të mundshëm. Tabela 15 tregon se si përqindja e burrave me flokë të zinj rritet në çdo grupmoshë nga fillimi i të 20 - ve deri në fund të të 50 - ve. Më pas në atë kohë ndodh diçka që e ul këtë raport.

Nga ana tjetër, burrat me flokë kafe të errët janë tre herë më të shumtë se ata që kanë patur flokë të zinj në rininë e tyre. Ata bëhen më të rrallë me kalimin e moshës, deri kur arrijnë moshën 40 vjeç, kur të dy grupet e ngjyrave janë të barabarta. Në moshën 60 vjeç, situata ndryshon. Burrat me flokë të zinj janë më të shumtë se ata me flokë kafe të errët në një raport mbi 3:1. Burrat me flokë kafe të çelët dhe biond, në përgjithësi, nuk pësojnë një zbehje kaq të dukshme. Në moshën 60 vjeç, si ata ashtu edhe grupi me flokë kafe të errët bëhen më të shumtë. Por në këtë moshë, shumica e burrave janë tashmë mjaft të thinjur. Duket sikur në disa raste, ngjyrat më të errëta të flokëve fillojnë të zbardhen në këtë moshë.

Nëse do të përshkruanim serinë tonë bazuar në një mostër të të intervistuarve në moshën 20 vjeç, atëherë do të duhej të thoshim pa hezitim se Gegët e Malësisë ishin kryesisht me flokë kafe, me disa individë biondë dhe me flokë të zinj në grupe të barabarta. Megjithatë, në moshën 45 vjeç, burrat me flokë të zinj do të ishin në shumicë. Ka shumë gjasa që kjo të jetë e vërtetë edhe për shumicën e popullatave të tjera evropiane, duke sugjeruar se ngjyra e flokëve varet nga mosha e kampioneve. Megjithëse ngjyra e syve tregon një numër ndryshimesh në lidhje me moshën, asnjëra prej tyre nuk është e krahasueshme në sasi me ato që kemi

diskutuar më parë dhe ato nuk ndikojnë në pozicionin e kampioneve. Përshkrimi për çdo moshë mbi 20 vjeç do të japë një pamje më të saktë të këtij karakteri për popullsinë e rritur mashkullore në tërësi.

MOSHA DHE DALLIMET NDËRFISNORE

Deri tani, në këtë kapitull shumica e studimeve mbi ndryshimet e moshës kanë shërbyer për të përcaktuar pozicionin e serisë në tërësi dhe për ta bërë atë të krahasueshme me seri të tjera. Disa nga këto analiza kanë vënë në dukje edhe dallimet ndërfisnore. Për shembull, është e qartë se shtatlartësia e njerëzve në veri të Drinit nuk lidhet me moshën, sidomos kur krahasohet me fqinjët e tyre në jug të Drinit. E njëjta gjë vlen edhe për ndryshimet lokale në përmasat e kokës. Për disa karakteristika të tjera, të cilat konsiderohen pika kyçe të ndryshimeve ndërfisnore, mosha nuk mund të përjashtohet aq lehtë. Ne kemi vërejtur se rënia e flokëve, ndryshimi i ngjyrës së tyre dhe lartësia e plotë e fytyrës ndryshojnë ndjeshëm me kalimin e viteve, prandaj është e nevojshme të shqyrtojmë efektin e këtyre ndryshimeve tek kampionet tona fisnore.

TABLE 16: AGE CONTROLS IN CRITICAL CHARACTERS.

	HAS		DUKAGIN	
No.	(28)	(114)	(45)	(106)
AGE	30-39	TOTAL	30-39	TOTAL
Biacromial	38.39 cm.	38.30	40.49	40.37
Total face ht.	125.86 mm.	126.30	123.44	124.15
Chins, bilateral	17.86%	19.30%	35.51%	38.68%
Buttocks, sm	32.14%	42.11%	2.22%	5.66%
Baldness, present	28.57%	46.00%	15.55%	20.19%
Eyebrows, lat. ext. abs. & sm.	53.57%	57.90%	11.11%	8.49%
Hair color				
Black	60.71%	61.46%	17.78%	20.75%
Brown	32.14%	22.92%	68.89%	66.04%
Other	7.14%	15.62%	13.33%	13.21%

Tabela 16 na ofron një pamje të tipareve në moshën kritike në Has.

Dukagjini dhe Hasi janë dy fise që dallohen mbi të gjitha të tjerat. Mes tyre, ata përfaqësojnë ato veçori që sugjerojnë se Gegët e Malësisë nuk përbëjnë një grup

tërësisht homogjen. Këto veçori, siç janë përshkruar në kapitullin e 10 - të tek "*Fenotipi i Gegëve të Malësisë*," përfshijnë diametrin biakromial, lartësinë totale të fytyrës, formën e mjekrës, vithet e gjëra, praninë ose mungesën e rënies së flokëve, zgjerimin anësor të vetullave dhe ngjyrën e flokëve të kokës.

Tabela 16 tregon pandryshueshmërinë e këtyre karakteristikave në Dukagjin dhe në Has. Për secilin fis, kam ndarë individët e moshës 30 - 39 vjeç dhe kam kryer llogaritje të veçanta. Duke barazuar shpërndarjen e moshës, mund të shpresojmë të zbulojmë nëse këto veçori lidhen me moshën apo jo.

Mua më rezulton se ato nuk lidhen. Dukagjinasit e moshës 30 - 39 vjeç kanë shpatulla po aq të gjera sa bashkëmoshatarët e tyre nga Hasi, njësoj si i gjithë kampioni në tërësi. Pavarësisht moshës, burrat e Hasit kanë fytyra më të gjata se burrat e Dukagjinit. Nga ana tjetër, burrat e Dukagjinit kanë mjekra më të gjera, më pak vithe të dobëta, më pak flokë të rëna në kokë, më shumë zgjerim anësor të vetullave dhe më shumë flokë kafe, kjo në krahasim me burrat e Hasit, në çdo grupmoshë. Këto ndryshime janë të vërteta. Ato janë po aq të theksuara në një grup përfaqësues të moshës, sa dhe në të gjithë kampionet. Has dhe Dukagjin përfaqësojnë popullata lokale që dallohen në këto aspekte, si nga seria totale ashtu edhe nga njëra tjetra.

NË SHQIPËRI, KA DISA GJETJE ARKEOLOGJIKE, SI KAFKA E PROVA TË TJERA TË GJETURA NË VERI TË VENDIT, QË VËRTETOJNË PRANINË E NJË TIPI MESO-KEFALIK, I CILI MENDOHET TË JETË NJË NDËRMJETËSIM MIDIS ILIRËVE TË TIPIT TË VJETËR DHE ATYRE TË TIPIT DINARIK.

KAFSHIMI

MEKANIZMI I OKLUZIONIT DENTAL[1]

Pasi kemi përshkruar fenotipin, pra karakteristikat trupore të Malësorëve Gegë dhe pasi kemi shqyrtuar disa nga ndryshimet që ndodhin gjatë viteve të jetës së tyre nga rinia në pleqëri, tani kalojmë në studimin e efektit të funksionit të një pjese të organizmit njerëzor, dhe konkretisht atij të aparatit përtypës, duke përfshirë dhëmbët, nofullat dhe harkun zigomatik.[2] Shumica e njerëzve besojnë se muskujt mund të zhvillohen përmes ushtrimeve dhe ky besim mbështet aktivitetet në palestra dhe programet e ushtrimeve atletike.

Zhvillimi i muskujve lë gjurmë tek kockat, të cilat, ndonëse janë të forta, janë deri në një farë mase edhe elastike. Ndër muskujt më aktivë në trupin e njeriut janë ata që operojnë nofullën e poshtme dmth, emporalët.[3] maseterët[4] dhe pterigoidët[5] e jashtëm dhe të brendshëm lart, si dhe platizmat[6] poshtë. Këta muskuj përdoren jo vetëm në përtypje dhe gëlltitje, por edhe në të folur. Forca e këtyre muskujve është e jashtëzakonshme. Një pajisje e përdorur nga dentistët për të matur forcën e kafshimit regjistron 35 paund presion për kafshim si një përtypje e zakonshme, në stilin amerikan.[7] Ndërsa forca efektive që mund të ushtrohet varion në varësi të një numri faktorësh, duke përfshirë fuqinë e muskujve të ndryshëm, detajet e levës

1 Okluzioni dentar është mënyra se si një dentist e përkufizon mënyrën se si dhëmbët e sipërm dhe të poshtëm bashkohen, kur mbyllni gojën. (Shënim i përkthyesit)

2 Harku zigomatik është një strukturë kockore në kafkë, që formohet nga bashkimi i dy kockave kryesore: kocka zigomatike (kocka e mollëzës) dhe kocka temporale. Ky hark shtrihet nga faqja në drejtim të veshit dhe është i rëndësishëm për formën e fytyrës, për lidhjen me muskujt që ndihmojnë në përtypje dhe për estetikën e përgjithshme të fytyrës. (Shënim i përkthyesit)

3 Muskujt e temporalit janë një grup muskujsh të fortë që ndodhen në anën e kokës dhe janë të përfshirë në lëvizjen e nofullës. Shënim i përkthyesit)

4 Muskujt maseterë janë muskuj të fuqishëm që gjenden në anën e fytyrës dhe janë kryesisht përgjegjës për ngrënien dhe kafshimin, duke ndihmuar në mbylljen e nofullës. Shënim i përkthyesit)

5 Pterigoidët janë dy muskuj të rëndësishëm që ndodhen në pjesën e brendshme të kafkës dhe kontribuojnë në lëvizjen e nofullës. Muskujt Pterigoidë: Ndahen në dy grupe, pterigoidi të jashtëm dhe pterigoidi të brendshëm. Shënim i përkthyesit)

6 Platysma është një muskul sipërfaqësor i qafës dhe pjesës së poshtme të fytyrës. Shënim i përkthyesit)

7 Baker, 1922, vol. 8, pp. 3-24. (Shënim i autorit)

kockore, si dhe numrin, pozicionin, madhësinë dhe gjendjen e dhëmbëve. Këta faktorë ndryshojnë sipas racës, gjinisë, moshës, shëndetit dhe përdorimit. Sipas teorisë mbizotëruese, njeriu normal, pasi i dalin dhëmbët e qumështit, fillon të kafshojë lehtë me dhëmbët e përparmë. Prerësit e sipërm mbivendosen pak mbi skajin e prerësëve të poshtëm, dhe kaninët[8] e bicuspidët[9] përshtaten pak a shumë me njëri-tjetrin. Kur i dalin dhëmbët e përhershëm, kjo lloj përshtatjeje vazhdon e zhvillohet më tej.

Ndërkohë që individi rritet, mund të ndodhë një nga këto tri gjëra:

a. Mbikafshimi i lehtë vazhdon në formën e tij normale bashkë me rritjen.
b. Me shtimin e forcës në përtypje, ai formon zakonin e lëvizjes së nofullës së poshtme përpara, duke bërë që prerësit të takohen teh më teh.
c. Me shumë pak përtypje, ai e lëviz nofullën e poshtme prapa dhe dhëmbët e qenit bashkë me prerësit e sipërm mbivendosen plotësisht mbi dhëmbët e qenit dhe prerësit e poshtëm.

Ky quhet mbikafshim i përparmë i dallueshëm, një defekt për të cilin prindërit shpesh paguajnë shumë para në Amerikë për ta korrigjuar kur ky shfaqet tek fëmijët e tyre.

Një faktor i rëndësishëm në këtë zgjedhje të kafshimeve është natyra e levizjes së kondilit[10] të nofullës së poshtme. Këtu nyja është shumë komplekse dhe lejon një sasi të madhe lëvizjeje përpara, mbrapa dhe anash.

Pra, cilëndo mënyrë që të zgjedhësh për të kafshuar, fossa mandibulare[11] e gjithanshme e bën përshtatjen të mundshme dhe kështu dhëmbët marrin pozitat e duhura brenda gojës. Akti i përtypjes së mishërave, drithërave, perimeve dhe ushqimeve gjatë gjithë jetës së njeriut ndikon shumë këtu. Dhe kjo vjen, jo vetëm prej ushqimeve që konsumojmë, por edhe prej mënyrës së përtypjes dhe forcës së dhëmbëve. Pavarësisht ngurtësisë së qelqtë të smaltit të dhëmbëve, ai prapë se prapë gërryhet. Kuspët,[12] të cilat shërbejnë si tehët e dhëmbëve ose që korrespondojnë me brazdat si në një gur mulliri, në kushte të caktuara konsumohen dhe bëhen të sheshta.

8 "Dhëmbët e qenit" ose thjeshtë "kafshuesit" kur i referohemi dhëmbëve të parë kafshues. (Shënim i përkthyesit)

9 Dhëmbët e katërt". Këta janë dhëmbët që ndodhen midis dhëmbëve prerës dhe dhëmballëve, të njohur gjithashtu si premolarë. (Shënim i përkthyesit)

10 Fjala "condyle" në shqip përkthehet si "kondil". Në anatomi, kondili është një pjesë e rrumbullakosur e një kocke që lidhet me një tjetër kockë, zakonisht në një nyje. (Shënim i përkthyesit)

11 Fossa mandibulare e ndryshueshme". Ky është një term anatomie që përshkruan një depresion në pjesën e poshtme të kockës së kafkës, ku lidhet mandibula (kocka e poshtme e fytyrës) dhe që lejon lëvizjen e saj. (Shënim i përkthyesit)

12 Fjala "cusp" në gojën e njeriut i referohet majës ose kulmit të një dhembi. Dhembët e njeriut kanë sipërfaqe që përdoren për të copëtuar dhe bluar ushqimin, dhe këto sipërfaqe kanë shpesh forma të mprehta ose të ngritura që quhen "cusps" (majëza). (Shënim i përkthyesit)

Një nga kushtet që ndikon është konsumimi i bukës së bluar në mullinj guri, i cili ndryshon në varësi të llojit të gurit. Kur kuspët janë konsumuar dhe bëhen të sheshta, dhe nëse kafshimi është teh më teh të dhëmbëve, atëherë sipërfaqet dentare të dy nofullave mund të bëhen të lëmuara, duke mundësuar një bluarje rrotulluese.

Kafshimi nuk bëhet kurrë thjesht lart e poshtë. Ai gjithmonë përfshin disa lëvizje anash dhe përpara - mbrapa. Megjithatë, deri në pikën e përmendur më sipër, këto lëvizje janë gjithmonë të kufizuara nga kuspët ose nga mbivendosja e dhëmbëve të përparmë. Në përgjithësi besohet se, tek një i rritur i pjekur, kafshimi teh më teh reflekton një përtypje më të ashpër, krahasuar me kafshimin "normal" me mbivendosje, duke qenë gjithçka tjetër e barabartë. Mbivendosja e theksuar supozohet të përfaqësojë mungesën e përtypjes që është e lidhur me konsumimin e ushqimeve shumë të përpunuara. Ajo është po aq karakteristike për nofullat e njerëzve të kohës së Perandorisë Romake sa edhe këtyre të kohëve tona. Duke qenë se është një nën - produkt i një civilizimi praktikisht të lartë, ndonjëherë mbivendosja e theksuar shihet edhe si e metë fizike. Ka edhe një lloj tjetër kafshimi, i njohur si 'kafshimi i poshtëm', në të cilin dhëmbët e poshtëm dalin më përpara se ata të sipërm. Ky është kafshimi i ashtuquajtur "bulldog," një anomali që ndodh në çdo kohë, në çdo vend ose popullatë. Ne në serinë tonë shqiptare kemi regjistruar katër llojet e kafshimit të përshkruara më sipër.

KAFSHIMI DHE MOSHA

Tabela 17 tregon lidhjen midis llojit të kafshimit dhe moshës. Burrat, të cilët e kishin kafshimin teh më teh, ishin gati 5 vjet më të vjetër se të afërmit e tyre që kishin një kafshim pak më të ndryshëm, pra me mbivendosje dhe ky dallim është domethënës me 9,63 herë gabimin e tij të mundshëm. Duke përjashtuar grupmoshën më të re si një mostër shumë të vogël, shohim se në moshën 20 - 24 vjeç përqindja e mbivendosjeve është pothuajse në një raport 3 me 1 më e madhe se ajo e okluzioneve teh më teh. Të dyja përqindjet bëhen të barabarta rreth moshës 35 vjeç, pas së cilës përqindjet e mëparshme përmbysen në fillim të të 50 - ve. Ndryshimet në raport që fillojnë në atë moshë dhe vazhdojnë deri në pleqëri shfaqin një rritje të përqindjes së burrave pa dhëmbë, në të cilët lloji i mëparshëm i kafshimit nuk mund të përcaktohej. Ato regjistrohen si "të panjohura." Prerësit që janë konsumuar aq shumë sa për të depërtuar në kavitetin e kockës kanë më

shumë gjasa të bien, krahasuar me ata që nuk janë konsumuar. Për këtë arsye, është e arësyeshme të thuhet se shumica e "të panjohurave" në grupmoshat më të mëdha kanë pasur kafshime teh më teh, por nuk mund të jemi krejtësisht të sigurt për këtë.

Është gjithashtu e arsyeshme, por e pasigurt, të supozohet se burrat që kanë patur kafshim me mbivendosje deri në moshën 52 vjeç, do ta ruajnë atë edhe për pjesën tjetër të jetës që iu ka mbetur. Duke shtuar "të panjohurat" në kategorinë teh më teh të kafshimit në tabelën 17, përftojmë shprehjen e këtij progresi hipotetik.

TABLE 17: BITE AND AGE.

MEAN AGES IN YEARS

	No.	Mean
Under	14	35.55 years
Edge-to-edge	521	41.53 ± .31
Slightly over	480	36.78 ± .35
Marked-over	10	38.00

PERCENTAGES OF BITE TYPES IN AGE GROUPS

Age	Under		Edge-Edge		Slightly-over		Marked-Over		Unknown		No.
18–19	0		6	50.00	5	41.67	1	8.33	0		12
20–24	3	3.03	26	26.26	69	69.69	1	1.01	0		99
25–29	0		63	40.65	91	58.71	1	.65	0		155
30–34	5	3.01	74	44.58	85	51.20	2	1.20	0		166
35–39	2	1.23	84	51.53	75	46.01	1	.61	1	.61	163
40–44	1	.78	66	51.16	57	44.19	1	.78	4	3.10	129
45–49	1	.97	65	63.11	35	33.98	0		2	1.94	103
50–54	1	1.14	59	67.05	23	26.14	2	2.27	3	3.41	88
55–59	1	1.96	29	56.86	14	27.45	0		7	13.73	51
60–64	0		32	57.14	14	25.00	1	1.79	9	16.07	56
65 +	0		17	41.46	12	29.27	0		12	29.27	41
?	0		3	75.00	0		0		1	25.00	4
Total	14	1.31	524	49.11	480	44.99	10	.94	39	3.66	1067

Tabela 17 ofron një pasqyrë të tipareve të kafshimit të lidhura me moshën, nën moshën 35 vjeçare, si dhe përqindjen e llojeve të kafshimit në grupmoshat e ndryshme. Në këtë tabelë, janë shënuar tiparet e kafshimit që janë klasifikuar si formate e pickimit, si dhe mosha mesatare, përqindjet e llojeve të pickimeve sipas grupmoshave, dhe numri i individëve.

Kjo tabelë (Tabela 17: Kafshimi dhe mosha) paraqet të dhëna për llojet e kafshimit (radhitja e dhëmbëve) në lidhje me grupmoshat. Ai kategorizon llojet e kafshimeve në katër grupe: Nën kafshimi, nga skaj në skaj, pak më i lartë dhe i shënuar mbi të, duke treguar moshat mesatare për secilën kategori dhe përqindjet e llojeve të kafshimeve brenda grupmoshave të ndryshme. Këtu është një përmbledhje e tabelës:

Mbivendosjet e theksuara janë aq të rralla sa që janë statistikisht pothuajse të papërfillshme. Ato janë të shpërndara në të gjitha grupmoshat në një mënyrë që nuk tregon rritje apo pakësim, dhe kjo përputhet me atë që dimë për zakonet e të ngrënit të Malësorëve Gegë. Kafshimet e poshtme nuk janë më të shpeshta apo më të rralla sesa pritej. Me këtë vëzhgim, ideja se llojet e okluzionit janë të trashëguara duhet të hidhet poshtë si e pa bazuar shkencërisht.

Asnjë infiltracion gjenetik, mjaftueshëm i fortë për të ndikuar në gjysmën e popullsisë, nuk mund të ketë depërtuar në Gegni gjatë jetës së subjekteve tona më të vjetra në moshë. Okluzioni është funksional, por çështja është nëse i gjithë ndryshimi i treguar në këtë seri është një ndryshim normal i moshës nga mbivendosja teh më teh, apo nëse mund të jetë pjesërisht për shkak të ndryshimeve në ushqime dhe zakone të të ngrënit, si futja e sheqerit dhe ndoshta blerja dhe transportimi i bukës së butë nga furrat e qytetit për në fshatra? Përgjigjen e kësaj pyetjeje ia lë ekspertëve të fushës dentare.

KAFSHIMI DHE GJEOGRAFIA

Tabela 18 tregon shpërndarjen fisnore të llojeve të kafshimit. Në këtë veçori, fiset ndryshojnë ndjeshëm dhe disa nga ndryshimet janë shumë të rëndësishme, si për shembull ai midis Mirditës dhe Lumës në kafshimin teh më teh, që arrin deri në 6.48 herë sa *gabimi i mundshëm.* Mirdita është shumë më e fortë në kafshimin teh më teh dukuri kjo e përhapur në përgjithësi deri në zonat më të largëta gjeografikisht në Gegni, përveç Hasit.

Me disa përjashtime, fiset verilindore kanë përqindjen më të lartë të fenomenit të mbikafshimeve të lehta. Në fillim mund të mendohet se katolikët ishin ata njerëzit me mbikafshimin teh më teh, por në 5 nga 6 fiset e të dy besimeve që vëzhguam, na doli që myslimanët paskan një raport më të lartë të mbikafshimit teh më teh. Ndërsa përjashtim bënin këtu katolikët e Malësisë së Gjakovës të cilët formojnë një popullsi të veçantë, atë të Nikajve dhe Mërturit, që ndodhet pak përtej ndarjes me krahinën e Shalës dhe Shoshit. Kështu pra nuk mund të thuhet se kafshimi nuk ka fare të bëjë me ritualet e zakonshme të të ushqyerit. As nuk duhet pritur kjo, pasi ndryshimi kryesor në dietë qëndron te lloji i mishit që konsumohet. Ndërsa ushqimet e tjera që kërkojnë më shumë përtypje, si për shembull buka, janë të njëjta për të dyja palët, për cilëndo krahinë për të cilën po flasim.

TABLE 18: BITE.
TRIBAL DISTRIBUTION OF TYPES

	TOTAL	UNDER		EDGE-TO-EDGE		SLIGHTLY OVER		MARKED-OVER		UNKNOWN	
		#	%	#	%	#	%	#	%	#	%
Total Series	1067	14		524		480		10		39	
MeM	105	2	1.90	56	53.33	43	40.95	0		4	3.81
Duk	106	0		60	56.60	46	43.40	0		0	
MeJ	104	2	1.92	35	33.65	67	64.42	0		0	
Has	114	3	2.63	73	64.04	30	26.32	1	.88	7	6.14
Lum	109	1	.92	31	28.44	68	62.39	4	3.67	5	4.59
Puk	102	4	3.92	37	36.27	59	57.84	1	.98	1	.98
Mir	101	2	1.98	70	69.31	19	18.81	2	1.98	8	7.92
Zad	105	0		49	46.67	51	48.57	0		5	4.76
Mat	104	0		51	49.04	51	49.04	0		2	1.92
Dib	108	0		58	53.70	42	38.89	2	1.85	6	5.56

BITE AND RELIGION

	CATHOLIC		MOSLEM		BOTH		PROPORTIONS OF E.-E.—S.-O.	
	E-E	SL.-O.	E-E	SL.-O.	OTHERS		CATH.	MOSLEM
MeM	27	23	29	20	6		54	59
Duk	60	46	0	0	0		56	—
MeJ	9	7	26	60	1		56	70
Has	8	3	65	27	11		67	71
Lum	0	0	31	68	10		—	31
Puk	11	24	26	25	6		44	52
Mir	70	19	0	0	12		79	—
Zad	45	42	4	9	5		52	31
Mat	4	6	47	45	2		40	51
Dib	0	0	58	42	8		—	58
Intertr.	2	2	7	7	2		50	50
Total	236	172	293	303	63	1067	58	49

Tabela 18 ofron një pasqyrë të kafshimit, duke treguar format e tij në grupe fetare të ndryshme, si katolikë dhe muslimanë, si edhe në grupet e tjera. Kjo tabelë ilustron të dhëna nga të dy grupet, të cilët në përgjithësi ushqehen në mënyrë të ngjashme, por edhe ndryshe nga njëri-tjetri, veçanërisht në përdorimin e mishit të derrit nga katolikët.

Ajo që vërteton kjo shpërndarje, më shumë se çdo gjë tjetër, është se mbikafshimet e lehta priren të shfaqen më shpesh në qytetet e mëdha tregtare lindore dhe zonat përreth rrugës romake. Puka, që ndodhet në mes të kësaj rruge, ka një furrë për shitje buke ndërsa Luma ka disa furra buke në Kukës. Të tjerët bëjnë tregti në Prizren dhe Peshkopi. Këto furra që shesin bukë, të paktën sipas përvojës time,

prodhojnë një bukë më të butë sesa furrat shtëpiake. Po pse, atëherë, Hasi ka një nga raportet më të larta të kafshimit teh më teh, kur pikërisht ata burrat e matur në Has vinin nga fshatra me furrtarë tregtarë brez pas brezi?

Përgjigja qëndron në larminë e moshës. Nga 28 burrat e grupmoshës 30 - 39 vjeç që vëzhguam në Has, 13 kishin kafshime teh më teh dhe 14 mbivendosje të lehta ose të theksuara. Raporti i kafshimeve teh më teh për këtë grupmoshë është 48%. Në Lumë, ku shfaqet ana tjetër e formës së kafshimit, rezulton se nga 25 burra në të njëjtin grupmoshë, 11 kishin kafshime teh më teh, 13 mbivendosje të lehta dhe 1 kishte kafshimin e poshtëm. Ky jep një raport prej 46%. Nëse numërohen mbivendosjet e theksuara së bashku me ato më pak të theksuara dhe kafshimet e poshtme së bashku me ato teh më teh, atëherë raportet përmbysen. Por duhet patur parasyshë fakti se furrtarët janë burra më të moshuar. Kështu që duhet bërë shumë më tepër kërkim nëse duam të shpjegojmë ndodhitë rastësore të okluzionit ndër Malësorët e Gegënisë. Ndaj gjithçka që ky raport mund të arrijë është të shërbejë si një njohje terreni për specialistët.

KAFSHIMI DHE GJATËSIA E FYTYRËS

Kemi parë në kapitullin 11, me titull "Mosha," se ndryshe nga pjesët e tjera të trupit, fytyra vazhdon të rritet gjatë gjithë jetës. Në pleqëri, megjithatë, kjo rritje shpesh ngadalësohet ose ndalon për shkak të përkeqësimit të strukturës dentale dhe humbjes së dhëmbëve. Ndërsa dhëmbët konsumohen dhe bien, kufijtë dentarë të të dy nofullave, si të sipërme ashtu edhe të poshtme, tkurren përmes ngushtimit të dhëmbëve, dhe mjekra e hunda afrohen me njëra tjetrën.

Këto procese kompensuese, rritja e fytyrës dhe degradimi i dhëmbëve, nuk lëvizin domosdoshmërisht me të njëjtin ritëm. Tek disa individë, dhëmbët mbeten të shëndetshëm deri në moshë të thyer. Ndërsa tek disa të tjerë, ata degradohen shumë më herët. Këto dallime ndikojnë jo vetëm në mesataret, por gjithashtu edhe në shpërndarjen dhe masat e ndryshueshmërisë, duke përfshirë këtu dhe gabimin e mundshëm.

Në një seri që përfshin një përqindje të madhe burrash të moshës së mesme, ose në një seri ku degradimi i dhëmbëve është i zakonshëm në çdo moshë, është e nevojshme të gjejmë një metodë për të eliminuar këtë trend gabimi.

Duke qenë i vetëdijshëm për këtë problem para se të nisesha për në Shqipëri, përfshiva në matje vëzhgimet mbi shkurtimin e fytyrës për shkak të ndikimeve

shëndetësore, si dhe shkurtimin e fytyrës për shkak të vjetërsisë dhe molisjes natyrore. Ishte më e lehtë të vëzhgoja gjendjen dentare duke marrë në konsideratë këto fenomene, sesa të bëja vëzhgime të përgjithshme dhe më pas të përpiqesha të vlerësoja efektet që këto fenomene shkaktojnë në lartësinë e fytyrës.

Tabela 19 shpalos anën tjetër të këtij fenomeni. Pamë që shkurtimi nga konsumimi ishte kryesisht i lidhur me llojin e mbikafshimit teh më teh. Kjo ndërkohë që zvogëlimi dhe molisja ishin më karakteristike për burrat që kishin pasur mbikafshime të theksuara dhe për pasojë dhëmbët e tyre ishin më pak të konsumuar. Kjo në rastet kur në gojë kishte dhëmbë të mjaftueshëm. Kështu që vetëm në 5 raste ishte e mundur të vërtetohej shkurtimi i dhëmbëve për këto shkaqe. Shkurtimi për shkak të konsumimit na rezulton se fillon 10 vjet më herët se ai për shkak të plakjes dhe molisjes. Mesatarja e lartësisë totale të fytyrës së burrave që kishin pësuar shkurtim nga konsumimi ishte ndjeshëm më e vogël se mesatarja totale, në kategoritë + dhe ++. E njëjta gjë ishte e vërtetë për ata që ishin subjekt i humbjes dhe molisjes vetëm në kategorinë ++.

Sa i përket mesatareve të lartësisë së pjesës së sipërme të fytyrës, rezultoi se ishin burrat ata që kishin pësuar humbje dhe molisje. Pra tek ata shfaqet reduktimi më i madh në të dy kategoritë, në atë + dhe ++. Mbështetur në këto shifra, dukej më e arësyeshme të eliminoheshin nga seritë e lartësisë totale të fytyrës, lartësisë së pjesës së sipërme të fytyrës dhe indeksit të varur, 164 burrat e regjistruar si + apo dhe ato ++ për cilëndo kategori.

Pas këtij korrigjimi, u llogaritën seritë e dhëna në tabelën 4. Devijimet shfaqeshin kryesisht nga grupmoshat më të vjetra dhe jo më shumë se 22 për qind e individëve u morën nga çdo fis. Një çështje tjetër që mbetet për t'u shqyrtuar është: A ndikon lloji i okluzionit në lartësitë e fytyrës kur konsumimi, mplakja dhe molisja janë eliminuar? Ndërkohë që mund të supozohet se, nëse dy burra kanë skelete dhe dhëmbë të njëjtë, dhe njëri prej tyre ka një mbivendosje të dhëmbëve, ndërsa dhëmbët e tjetrit takohen teh më teh, ky i fundit do të kishte fytyrën më të gjatë. Por, siç tregon pjesa e fundit e tabelës 19, kjo nuk rezulton kështu. Okluzioni nuk ka asnjë efekt të drejtpërdrejtë në gjatësitë e fytyrës, përveçse nëpërmjet konsumimit, mplakjes dhe molisjes.

TABLE 19: BITE, AGE, AND FACE SHORTENING.

FACE SHORTENING, FREQUENCIES

Shortening, if any, due to:	abs.	ssm	sm	+	++	+++	Total	Grand Total
Wear	808	4	162	66	21	1	(254)	1062
Loss	1006	1	4	25	23	3	(56)	1062
Both				1	3		(5)	5
				Loss 1 Wear				
(Neither) ..	(752)						(752)	
Total	923*				164			1067
	kept				removed			

(*Of 923 left, 921 have face heights.)

TABLE 19 (*continued*)

AGE

	No.	MEAN (YRS.)	×P.E. FROM ABS.-ABS.
No wear, no loss.....	750	36.26 ± .28	
Abs.-Abs.			
Wear: ssm & sm.....	161	43.24 ± .60	10.58
+	67	48.08 ± 1.29	8.95
++, +++	25	53.50 ± 1.12	15.00
Loss: ssm, sm, + ...	31	53.29 ± 1.16	12.00
++, +++	29	55.28 ± 1.00	18.33

FACE LENGTHS AND FACE SHORTENING ON THE BASES OF (A) WEAR, AND (B) LOSS AND ABSORPTION

TOTAL FACE HEIGHT

	WEAR					LOSS & ABSORPTION				
	No.	MEAN	σ	Δ	×P.E.	No.	MEAN	σ	Δ	×P.E.
Total	1065	123.25 ± .14	6.75			1065	123.25 ± .14	6.75		
sm	163	122.95 ± .25	5.35	.30 ± .36	.84	4	128.00			
+	67	121.55 ± .63	7.60	1.70 ± .55	3.09	27	122.35 ± .29	2.20	.90 ± .88	1.03
++	25	120.80 ± .76	5.65	4.15 ± .69	6.02	26	117.40 ± .81	6.00	5.85 ± .89	5.75

UPPER FACE HEIGHT

	WEAR					LOSS & ABSORPTION				
	No.	MEAN	σ	Δ	×P.E.	No.	MEAN	σ	Δ	×P.E.
Total	1065	73.25 ± .11	5.20			1065	73.25 ± .11	5.20		
sm	162	73.35 ± .27	5.05	.10 ± .28	.36	4	77.00			
+	67	72.05 ± .47	5.75	1.20 ± .43	2.79	27	70.70 ± .72	5.55	2.55 ± .67	3.81
++	25	72.60 ± .69	5.15	.65 ± .70	.93	26	69.10 ± .73	5.55	4.15 ± .69	6.02

DENTAL REJECTS

AGE	No.	% OF WHOLE	TRIBE	No.	% OF WHOLE
18–19.....	0	0	MeM	23	21.9
20–24.....	1	1.1	Duk	5	4.7
25–29.....	2	1.3	MeJ	9	8.7
30–34.....	3	1.8	Has	23	20.2
35–39.....	11	6.8	Lum	10	9.2
40–44.....	18	14.0	Puk	11	10.8
45–49.....	18	17.5	Mir	22	21.8
50–54.....	27	30.7	Zad	8	7.5
55–59.....	22	42.3	Mat	11	10.6
60–64.....	19	33.9	Dib	23	21.3
65	25	61.0	Interm.	3	2.8

FACE HEIGHTS AND BITE TYPE

Means of the Corrected Series

	EDGE-TO-EDGE		SLIGHTLY-OVER	
	No.	MEAN	No.	MEAN
Total face height.....	430	123.40 ± .21	461	123.95 ± .20
Upper face height	430	73.60 ± .16	461	73.50 ± .16

Tabela 19 tregon grafikun e kafshimit, lidhjen midis moshës dhe ndryshimeve në përmasat e fytyrës gjatë procesit të plakjes te malësorët Gegë të Shqipërisë së Veriut.

KAFSHIMI DHE GJERËSIA E FYTYRËS KARAKTERISTIKAT DHE EFEKTET NDËRVEPRUESE

Faktorët e okluzionit ndikojnë në zgjerimin e fytyrës, dhe ky tashmë është një fenomen i vërtetuar. Një zhvillim progresiv i muskujve temporalis, masseter[13] dhe pterygoid[14] mund të shkaktojë rritje në harkimin dhe zgjerimin e harkut zigomatik,[15] gjë që reflektohet në diametrin bizigomatik.

Tabela 20 përmban statistikat përkatëse. Pra në përgjithësi, burrat që kafshojnë teh më teh kanë fytyra pak më të gjera se burrat me mbivendosje, por diferenca është vetëm 2.83 herë sa *gabim i mundshëm,* pra, pak më e vogël sesa ajo që pritej. Fakti që burrat me mbivendosje ishin 5 vjet më të rinj se të tjerët mund ta lidhë këtë edhe me moshën. Nuk pritet që vetëm kafshimi të lidhet me gjerësinë e fytyrës, por më tepër se kjo mund të jetë sasia e presionit të përdorur me lloje të ndryshme kafshimi. Ky presion mund të matet më së miri nga efekti i tij në dhëmbë, pra, nga mënyra e ngrënies.

Në kategorinë teh më teh, mesatarja bizigomatike rritet, megjithëse jo rregullisht, bashkë me sasinë e konsumimit. Dy nga tre prej këtyre rritjeve mbi mesataret e kategorisë pa konsumim janë të rëndësishme. Burrat e grupuar sipas kategorive të konsumimit gjithashtu ndryshojnë në moshë, dhe mesatarja bizigomatike për çdo kategori konsumimi ndjek nga afër atë të grupit përkatës të moshës.

Gjerësia e fytyrës rritet 3 deri në 4 milimetra gjatë jetës tek një i rritur, deri në fund të viteve '50. Kjo rritje duket se është e përqendruar tek burrat me kafshimet teh më teh. Shumica e burrave me mbikafshime janë më të rinj në moshë. Edhe pse konsumimi dhe rritja duken se shkojnë së bashku, nuk mund të tregojmë me siguri një marrëdhënie shkakësore midis tyre. Kjo mund të sugjerohet vetëm si një mundësi e vlefshme për një testim eksperimental.

---

13 Masseter" i referohet njërit prej muskujve kryesorë që çfarë ndihmon në përtypjen e ushqimit. Ky muskul ndodhet në pjesën e poshtme të nofullës dhe është përgjegjës për mbylljen e nofullës, që është një lëvizje kyçe gjatë përtypjes. Masseteri është një nga muskujt më të fuqishëm të trupit në lidhje me madhësinë e tij. (Shënim i përkthyesit)

14 Fjala "pterygoids" i referohet dy muskujve të vendosur në zonën e nofullës, të quajtur muskujt pterygoid medial dhe pterygoid lateral. Këta muskuj janë pjesë e grupit të muskujve që ndihmojnë në lëvizjen e nofullës, duke përfshirë lëvizje si hapja, mbyllja dhe lëvizjet anësore të nofullës. (Shënim i përkthyesit)

15 Fjala "zygomatic" i referohet diçkaje që lidhet me kockën zygomatike ose kockën e mollëzës, e cila është një kockë që ndodhet në pjesën e përparme të fytyrës dhe formon pjesën e mollëzës. Kjo kockë ndihmon në formimin e pjesës laterale të orbitës së syrit dhe kontribuon në strukturën e fytyrës. Termi "zygomatic" përdoret shpesh në anatomi për të përshkruar struktura ose muskuj që janë të lidhur me këtë kockë. (Shënim i përkthyesit)

TABLE 20: THE BIZYGOMATIC DIAMETER, BITE, AND TOOTH WEAR.

	No.	MEAN (MM.)	AGE (YRS.)	AGE MEAN (MM.)
Overbites	490	141.84 ± .24	36.78	142.65 ± .27
Edge-to-edge	524	142.82 ± .24	41.53	142.85 ± .30
E-E abs. wear.....	275	141.32 ± .22	36.26	142.65 ± .27
E-E ssm-sm wear	162	143.05 ± .31	43.24	142.85 ± .30
E-E + wear.....	64	142.39 ± .57	48.08	143.20 ± .37
E-E ++, +++ wear.....	23	144.18 ± .75	53.50	143.09 ± .43

Tabela 20 jep një grafik numerik të diametrit bizygomatic, lidhjen midis kafshimit dhe viteve të dhëmbëve, siç janë tejkafshimi, kafshimi i thellë, etj.

Cilado qoftë arsyeja, Gegët tanë do të ishin 3 ose 4 milimetra më të gjerë në diametrin bizigomatik krahasuar me një seri burrash, gjenetikisht më të rinj. Kjo duhet të merret parasysh në krahasimet ndërmjet serive.

Për të testuar më tej efektin e kafshimit, u bënë seri të ngjashme me ato për diametrin bizigomatik, ashtu si dhe për diametrin bigonial, por nuk u gjetën ndryshime. Kjo pra, provon atë që kjo përmasë nuk rritet sipas moshës.

Vëzhgimet tona mbi daljen përpara dhe anash të *malareve* dhe faqet e mbushura vërtetuan gjithashtu se efektet e kafshimit, nuk shkatojnë ndryshime. Në këto aspekte, fenotipi nuk ka nevojë për kualifikim të mëtejshëm, përveçse në kuptimin që:

Trekëndëshi i pjesës së poshtme të fytyrës, që shkaktohet nga gjerësia relative e diametrave bizigomatik dhe bigonial, vjen duke u rritur me moshën. Dhe kjo shfaqet më së shumti kur tipi i veçantë Dinarik është një individ i moshuar.

NËSE SHQYRTOJMË ANKETAT MË TË HERSHME ANTROPOMETRIKE TË ZVICRËS PËR SHEMBULL, GJEJMË DALLIME PO AQ TË MËDHA MIDIS BANORËVE TË LUGINAVE TË IZOLUARA NË DISA NGA KANTONET E SAJ. NË KËTO ASPEKTE, MUND TË THEMI SE SHQIPËRIA SIGURISHT QË NUK ISHTE NË NJË POZICION MË TË FAVORSHËM NË VITIN 1929 SESA Ç'ISHTE ZVICRA NË VITET 1880.

TOKA

TOKA DHE BIMËSIA

Është e rëndësishme të theksohet se çështja e cilësisë së tokës dhe ndikimi i saj në mbijetesën dhe ushqyerjen e popullsive që jetojnë në një vend është jetikë. Pra rëndësia e pjellorisë së tokës dhe e prodhimeve që banorët marrin nga kjo tokë është pohuar shpesh si faktor përcaktues, por pothuajse po aq shpesh edhe është mohuar. Gjithsesi, pa asnjë dyshim të bazuar, lloj i prodhimeve që nxjerr kjo tokë është një faktor i rëndësishëm në përmasat e trupit të banorëve që banojnë aty, ashtu si edhe të gjallesave të tjera që jetojnë në atë territor.

Boas[1] e tregoi këtë vite më parë në punën e tij mbi fëmijët e emigrantëve[2] në punimet e tij mbi këtë temë. Matheny dhe Meredith kanë treguar se djemtë italianë të rritur në Minnesota arrijnë, në moshën 17 vjeç, një lartësi mesatare prej 171.1 centimetra, një shifër shumë më e lartë se çdo mesatare e raportuar për moshatarët e tyre në Itali.[3]

Në Shqipërinë Veriore kemi zbuluar se mesatarja e lartësisë së banorëve të fiseve ndryshon nga njëra tjetra me më pak se 7 centimetra në grupet krahasuese të të rriturve. Ky ndryshim nuk është shumë i madh po t'u referohemi popullatave gjenetikisht të ngjashme dhe nëse ato janë rritur në kushte të ndryshme ushqimore. Nëse shqyrtojmë anketat më të hershme antropometrike të Zvicrës për shembull, gjejmë dallime po aq të mëdha midis banorëve të luginave të izoluara në disa nga kantonet e saj. Sondazhet e kryera një gjysmë shekulli më vonë, pasi metodat moderne të shpërndarjes së ushqimit dhe higjiena moderne po zbatoheshin gjerësisht, treguan një skicë të lartësisë trupore shumë më uniforme.

1 Boas, 1911; 1912, pp. 530-62. (Shënim i autorit)
2 Matheny dhe Meredith, 1947, pp. 344-55. (Shënim i autorit)
3 Schlaginhaufen, 1946, tekst dhe atlas; Coon, 1939, fq. 550-52, dhe Ripley, 1899, fq. 281-89, për diskutim dhe burime. (Shënim i autorit)

Në këto aspekte, mund të themi se Shqipëria sigurisht që nuk ishte në një pozicion më të favorshëm në vitin 1929 sesa ç'ishte Zvicra në vitet 1880.

Gegët e marrin ushqimin nga toka e tyre, aty ku rriten bimët dhe perimet dhe prej tyre ushqehen edhe kafshët që u japin atyre mishin dhe qumështin, të cilat gjithashtu burojnë nga e njëjta tokë. Një nga elementët më të rëndësishëm që duhet të merret parasysh është edhe gëlqerja, e cila është thelbësore për rritjen e kockave. Megjithatë, sa gëlqere iu nevoijtet njerëzve dhe sa prej asaj që gjendet në tokë arrin tek nnjeriu, kjo mbetet e panjohur. Vitet e fundit i është kushtuar shumë vëmendje elementeve gjurmë, të cilat janë të nevojshme për procese të ndryshme metabolike. Megjithatë, edhe kjo temë mbetet pak e njohur. Na thuhet se plehrat kimike nuk arrijnë të rikthejnë elementet të nxjerra nga toka dhe se plehu organik është shumë më i efektshëm.[4]

Shumë pak dihet për tokat e Shqipërisë Veriore madje as sa për të na lejuar ne të realizojmë një studim të detajuar të marrëdhënies së tyre me tokën. Megjithatë kjo na bën të mundur të shqyrtojmë faktin se deri në çfarë mase tiparet antropologjike përkatëse të këtyre banorëve përshtaten me karakteristikat gjeologjike.

Kjo e fundit është përshkruar tashmë në kapitullin 2, "*Toka e Gegëve të Malësisë*", ku janë përcaktuar zonat kryesore gjeologjike, sipas Almagià,[5] në figurën 2. Gëlqerorja e Mesozoikut në Malësinë e Madhe, në Shalë dhe në Malësinë e Gjakovës është një vazhdim jugor i Karstit të Shkretë,[6] të Malit të Zi. Edhe pse kjo zonë është e varfër për bujqësi dhe shumë prej saj është e përshtatshme vetëm për kullotjen e dhive, njerëzit në të dy anët e kufirit, megjithëse shpesh janë të keq ushqyer, janë të gjatë dhe kanë kocka të mëdha. Krahina e lartë vargmalore që shtrihet nga ana lindore e Malësisë së Madhe, kalon thuajse mes përmes tërë Pukës, në të gjithë Mirditën dhe në disa pjesë të Zadrimës, Matit dhe Dibrës. Ajo është në disa vende e pyllëzuar. Toka është e ngjashme me atë që shihet në disa ferma shumë të shfrytëzuara në New England - in verior.

Zona lindore e shkëmbinjve të metamorfizuar të Triasit[7] dhe Paleozoikut

4 Howard, 1947 (Shënim i autorit)

5 Almagià, 1932, map on p. 467. (Shënim i autorit)

6 "Barren karst" (në origjinal) është "karst i shkretë." Ky term përdoret për të përshkruar një peizazh karstik që karakterizohet nga mungesa e vegetacionit dhe mbulesës së tokës. Shënim i përkthyesit)

7 Termi "Metamorphosed Triassic" i referohet shkëmbinjve ose formacioneve gjeologjike që fillimisht u formuan gjatë periudhës Triasike (rreth 250 - 200 milionë vjet më parë), por që kanë pësuar ndryshime ose transformime përmes proceseve metamorfike. (Shënim i përkthyesit)

të Sipërm[8] shtrihet mbi livadhe të hapura dhe fusha me tokë të murrme, me pyje nëpër shpate malesh dhe grupe plepash rreth fshatrave. Këto janë tri zonat kryesore gjeologjike. Atyre mund t'u shtohet zona e palosjes intensive të shtresave të Mesozoiut dhe Eocenit,[9] përgjatë të dy anëve të Drinit në Shosh, Nikaj dhe fshatrat veriore të Pukës. Udhëtari që ecën përgjatë rrugës së periudhës romake, mund të shohë vendet ku lumi ka çarë malet dhe shkëmbinjtë, duke formuar shtratin e tij në disa vende, duke krijuar leqe të përdredhura në formën e germës 'S'. Në zonën verioro - qendrore të Matit ndodhet një mbulesë gëlqerore e periudhës terciare që ndërpret vijueshmërinë e Gabros.[10] Asnjë fshat nuk është me banim të përhershëm në ato zona. Megjithatë, dhitë dhe bagëtitë e tjera nga fshatrat fushore dërgohen atje për kullota verore. Qumështi dhe mishi i tyre pastaj përdoren nga fshatarët në familjet e tyre në vendbanimet e tjera ku ata banojnë.

